

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trishtim në botën e serialeve turke! Ndahet nga jeta aktoria e “Dashuri e Ndaluar”! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/trishtim-ne-boten-e-serialeve-turke-ndahet-nga-jeta-aktoria-e-dashuri-e-ndaluar/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:18:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:15:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a17733fb555ed0e528154080170a4ea6eef96c5da1e405fa96f3a0795aff2a6
TEKSTI	9ce10ab3e0f703884da2b7819e09a03a19bd5567942f7695aef442973406524b
PAMJA	8025a86a41aefb729cac66779c8b7388410a50105332f2c7bcb201a344d3e527

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	78527c0a6b2723f38488fdb90614777b7ec08cd6e1c347a42bbb2ef4e1f437de
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/78527c0a6b2723f38488fdb90614777b7ec08cd6e1c347a42bbb2ef4e1f437de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Trishtim në botën e serialeve turke! Ndahet nga jeta aktorja e “Dashuri e Ndaluar”!



Redaksia K

18 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Një tjetër figurë e njohur e kinemasë dhe televizionit turk është ndarë nga jeta. Aktorja Gülsen Tuncer, e cila u bë e njohur për publikun shqiptar përmes serialit shumë të dashur “Dashuri e Ndaluar” (Aşk-ı Memnu), ka vdekur në moshën 81-vjeçare.

Lajmi i trishtë u bë publik më 17 shtator dhe u konfirmua nga Film-San Vakfı, ndërsa edhe organizata të tjera artistike në Turqi kanë shprehur ngushëllimet për familjen dhe të afërmit e aktores.

Tuncer kishte qenë duke marrë trajtim për një sëmundje të rëndë dhe, sipas raportimeve të mediave turke, pak ditë para vdekjes ishte diagnostikuar me kancer të trurit në fazën e katërt.

Për publikun që e njeh nga seriali “Dashuri e Ndaluar”, ajo do të mbetet gjatë në kujtesë përmes personazhit Arsen Hanım, një prej figurave të serialit që solli në ekran historinë e familjes Ziyagil. Roli i saj në serial e bëri të njohur për një audiencë shumë të gjerë.

Por karriera e Gülsen Tuncer ishte shumë më e gjerë se vetëm ky rol. E lindur në Adana në vitin 1945, ajo u diplomua në Degën e Teatrit të Konservatorit të Bashkisë së Stambollit, ku gjatë formimit të saj artistik mësoi edhe nga emra të njohur të teatrit turk, mes tyre Yıldız Kenter dhe Ayla Algan.

Karrierën profesionale në teatër e nisi në vitin 1968, me shfaqjen “Zilli Zarife”, në teatrin e Gülriz Sururi dhe Engin Cezzar. Për më shumë se pesë dekada, ajo punoi në teatër, kinema dhe televizion, duke u angazhuar gjithashtu si artiste e dublimit, tekstshkruese, kompozitore dhe drejtuese artistike.

Tuncer nuk ishte aktive vetëm para kamerave. **Gjatë karrierës së saj** ajo punoi edhe në prapaskenë, duke qenë asistente dhe ndihmëse regjie në rreth 40 filma. Ajo u vlerësua gjithashtu për interpretimet e saj në produksione të ndryshme filmike dhe mori çmime për role dytësore.

Përveç “Aşk-ı Memnu”, ajo u shfaq në produksione si “Çalıkuşu”, “Fazilet Hanım ve Kızları” dhe “Üç İstanbul”, duke lënë pas një karrierë të gjatë në artin turk.

Pas lajmit për vdekjen e saj, kolegë dhe figura të njohura të artit turk kanë ndarë mesazhe lamtumire. Organizata që njoftoi humbjen e saj e përshkroi Tuncer si një artiste që la gjurmë përmes artit, elegancës dhe humanizmit të saj.

Ceremonia mortore e aktorese është planifikuar për 20 shtator 2026, në xhaminë Şişli, pas së cilës ajo do të prehet në varrezat Topkapı Kozlu në Stamboll.

Me largimin e Gülsen Tuncer, publiku i “Dashuri e Ndaluar” humbet një tjetër prej fytyrave që i dha jetë historisë së serialit. Për shumë shikues shqiptarë, emri i saj do të mbetet i lidhur përgjithmonë me Arsen Hanım dhe një prej serialeve turke më të ndjekura në vend.

LAJME TË NGJASHME



Aktorja e njohur turke zbulon arsyen e lidhjes së saj me shqiptarët!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Çfarë dihet për terapinë hiperbarike me oksigjen, po studiohet për kundër plakjes?



"E dashura jote duhet të shkojë me dikë tjetër"/ Avokat Ngjela zbulon kurën për ...



"Nuk mund ta lija jetim"/ Pse nuk u bë kurrë baba? Spartak Ngjela rrëfhet: Më mirë mos prano të bësh fëmijë, sesa...



Greta Kazazi zbulon si është sot raporti me Selin dhe planet për të ardhmen!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Majko përlozet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Ky është monoliti më i madh në Afrikë dhe një nga më të mëdhenjtë në botë...

EDITORI SUGJERON



Çfarë dihet për terapinë hiperbarike me oksigjen, po studiohet për kundër plakjes?



Red Light Therapy, çfarë tregojnë studimet për terapinë me dritë të kuqe dhe përfitimet e saj?



Më shumë vite, më shumë shëndet: 7 zakone që mund t'i përfshini në jetën tuaj!



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..."/ Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Te kisha çerekun e egove të kolegeve të mia..."/ Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!





10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të vicit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!



Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.